

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-37/021	Data: Datum: 01.02.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoj kërkesën 08 Nr.14/021, të datës 01.02.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për përkrahje me karburant dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 08 Nr.14/21 e datës 01.02.2021, e parashtruar nga Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe përkrahen me karburant: Berat Imeraj nga Istogu, pronar i kompanisë "ARBENS GARDEN" me 300 litra karburant dhe Afrim Mehmetaj me bager nga fsh. Llukaci i Thatë, përkrahet me 100 litra karburant, të cilët janë angazhuar që ti kryejnë aktivitetet për dëmet që janë shkaktuar nga fatkeqesitë e fundit natyrore nga era, bora dhe vershimet nga shiu në fsh. Serbobran të komunitet, në fsh. Kovragë dhe në fsh. Llukafci i Thatë.
2. Obligohet Zyrtari për transport 1 që Berat Imeraj dhe Afrim Mehmetaj ti paisë me vërtetim për furnizim me karburant, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Zyrtari për Transport 1.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, ka parashtruar kërkesën 08 Nr.14/21, të datës 01.02.2021, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet përkrahje me karburant, Berat Imeraj, pronar i kompanisë "ARBENS GARDEN" dhe Afrim Mehmetaj me bager, të cilët janë angazhuar në eliminimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesitë e fundit natyrore nga era, bora dhe vershimet nga shiu.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresa e DSHMSH shihet se është e nevojshme të përkrahen me karburant Berat Imeraj, pronar i kompanisë "ARBENS GARDEN" me 300 litra karburant gjithashtu përkrahet edhe Afrim Mehmetaj me nga 100 litra karburant të cilët janë angazhuar që ti kryejnë aktivitetet për dëmet që janë shkaktuar nga fatkeqesia e fundit natyrore nga era, bora dhe vershimet nga shiu në fsh. Serbobran të komunitet, në fsh. Kovragë dhe në fsh. Llukafci i Thatë.

Zyrtari për Transport 1 do të pajisë me vërtetim për furnizim me karburante nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim në pajtim me procedurat që vlejnë edhe për automjetet zyrtare. Zyrtari për Transport 1, kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant të Berat Imeraj dhe Afrim Mehmetaj si do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Berat Imeraj, Afrim Mehmetaj, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Zyrtari për Transport 1 dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyres së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.39/021	Data: 02.02.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 22 paragrafi 2 nenparagrafi 2.2. të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) dhe nenit 19 të Rregullore Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, me lajmërimin 02Nr.04/021 të datës 01.02.2021 nga Menaxheri i Personelit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të nëpunësit civil Beqir Metaj, titulli i postit: Udhëheqes i Sektorit për Bujqësi Zhvillim Rural, nxjerr:

V E N D I M

1. **KOMPENZOHE**: nëpunësi civile **Beqir Metaj**, titulli i postit: Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi, dhe Zhvillim Rural në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, në lartësi prej një page mujore të cilën e ka realizuar, për shkak të pensionimit.
2. Nëpunësit civil të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **26.01.2021**.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
1. Zyrtari Financiar për paga meditje dhe kompensime, obligohet të bëjë pagesën e një page mujore të realizuar, sipas procedurave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
2. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Menaxheri i Personelit, Zyrtari Financiar për paga meditje dhe kompensime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Beqir Metaj, Menaxheri i Personelit, Zyrtari Financiar për paga meditje dhe kompensime dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 41 /021	Data: Datum: 04.02.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 22 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.8/2019), Drejtoria për Administratë Komunale shqyrtoi kërkesën me Nr.02-016-4051, të datës 02.02.2021, të parashtruar nga Selim Džogović, Zyrtar për Gjendje Civile 1, në Drejtorinë për Administratë Komunale, për pezullimin e vendit të punës dhe i propozoi Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M PËR PEZULLIMIN E VENDIT TË PUNËS

1. **MIRATOHET** kërkesa Nr.02-016-4051 e datës 02.02.2021, e parashtruar nga Selim Džogović, Zyrtar për Gjendje Civile 1, në Drejtorinë për Administratë Komunale dhe i pezullohet vendi i punës, i cili kandidon për deputet në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
2. Të lartpërmendurit i pezullohet vendi i punës nga data 27.01.2021 deri me datë 19.02.2021.
3. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa përkatësishtë Zyrtarja Financiare për Paga Meditje që të percjellë Vendimin tek Divizioni i Pagesave në Ministrinë e Financave për Selim Džogović të cilit i pezullohet vendi i punës sipas pikës 2 të këtij Vendimi.
4. **Zyrtarja Financiare për Paga dhe Mëditje obligohet që nga data 20.02.2021 të lajmëroj punëtorin në listën e pagave si i rregulltë.**
5. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyrtarja Financiare për Paga Meditje dhe Menaxheri i Personelit
6. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen Kontesteve dhe Ankesave në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi

Me nga një kopje të këtij Vendimi njoftohen: Selim Džogović, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyrtarja Financiare për Paga Meditje, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-42/021	Data: Datum: 05.02.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e datës 05.02.2021 të parashtruar nga KQZ përmes Armanda Loshi Zyrtare e Lartë e Zgjedhjeve, për transportimin e materialit dhe trajnerëve nëpër qendrat e votimit në Komunë ne Istogut, dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa e datës 05.02.2021 e parashtruar nga KQZ përmes Armanda Loshi, Zyrtare e Lartë e Zgjedhjeve, për transportimin e materialit dhe trajnerëve nëpër qendrat e votimit në Komunën e Istogut dhe i lejohet shfrytëzimi i automjetit TOYOTA 03Z-18-06, i cili është në pronësi të komunës.
2. Obligohet Zyrtari i Transportit 1, që të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit në sasi sipas nevojës në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit.
3. Komisioni Komunal për Zgjedhje mundet të shfrytëzoj automjetin e lartëpërmendur për nevojat e komisionit deri sa të kryhen zgjedhjet parlamentare.
4. Automjetin mund të ngas zyrtari i cili caktohet nga KKZ si dhe anëtarët e komisionit.
5. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Zyrtari i Transportit 1.
6. Ky vendim është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetarja e KKZ-së, Zyrtari i Transportit 1 dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 43 /021	Data: Datum: 05.02.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b): të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 22 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.8/2019), shqyrtoj kërkesën e Menaxherit të Personelit të datës 05.02.2021 për pezullimin e vendit të punës për Fazli Stollaj, Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative në Drejtorinë për Administratë Komunale dhe nxjerr:

V E N D I M PËR PEZULLIMIN E VENDIT TË PUNËS

1. **MIRATOHET** kërkesa e Menaxherit të Personelit të datës 05.02.2021 për pezullimin e vendit të punës për Fazli Stollaj, Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative në Drejtorinë për Administratë Komunale dhe i pezullohet vendi i punës, i cili kandidon për deputet në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
2. Të lartpërmendurit i pezullohet vendi i punës nga data 27.01.2021 deri me datë 19.02.2021.
3. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa përkatësishtë Zyrtarja Financiare për Paga Meditje që të percjellë Vendimin tek Divizioni i Pagesave në Ministrinë e Financave për Fazli Stollaj të cilit i pezullohet vendi i punës sipas pikës 2 të këtij Vendimi.
4. **Zyrtarja Financiare për Paga dhe Mëditje obligohet që nga data 20.02.2021 të lajmëroj punëtorin në listën e pagave si i rregulltë.**
5. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyrtarja Financiare për Paga Meditje dhe Menaxheri i Personelit
6. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen Kontesteve dhe Ankesave në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi

Me nga një kopje të këtij Vendimi njoftohen: Fazli Stollaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyrtarja Financiare për Paga Meditje, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.44/021	Data: Datum: 05.02.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58, pika b të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në paragrafin 4 të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2019) dhe në nenin 49 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), shqyrtoi kërkesën Nr.01-016-4663 të datës 04.02.2021 të parashtruar nga Alketa Bytyqi, Asistente Administrative pranë Zyrës së Kryetarit, për ndërprerjen e pushimit të lehonisë, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** Kërkesa Nr.01-016-4663 të datës 04.02.2021 e parashtruar nga Alketa Bytyqi, Asistente Administrative pranë Zyrës së Kryetarit, për ndërprerjen e pushimit të lehonisë pa pagesë në kohëzgjatje prej 3 muajve.
2. Alketa Bytyqi, Asistente Administrative pranë Zyrës së Kryetarit, i ndërprehet pushimi i lehonisë pa pagesë në kohëzgjatje prej 3 muajve dhe obligohet të dalë në punë me datë 06.02.2021, nese nuk lajmerohet në punë me këtë datë dhe nuk paraqet ndonjë arsye konsiderohet se ka hequr dorë nga marrëdhënia e punës.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Menaxheri i Personelit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi në Komisionin për ankesa dhe parashtrës.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: Alketa Bytyqi, Menaxheri i Personelit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01.Nr.45/021	Data: 11.02.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë për Arsim 05.Nr.42/2021 të datës 03.02.2021, për kompensimin në lartësi prej 3(tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Teuta Bujupi, me titull të postit: Mësimdhënëse e mësimit klasor (1-5) në Shfmu "Bajram Curri" në Istog, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa 05.Nr.42/2021 e datës 03.02.2021, e parashtruar nga Drejtoria për Arsim për kompensimin në lartësi prej 3(tri)pagave mujore që i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Teuta Bujupi, me titull të postit: Mësimdhënëse e mësimit klasor (1-5) në Shfmu "Bajram Curri" në Istog.
2. Mësimdhënëses së lartpërmendur i përfundon shërbimi me 03.03.2021.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim.
4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime në Drejtorinë për Arsim, obligohet që Teuta Bujupi, t'ia bëjë pagesën, e 3(tri)pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Teuta Bujupi, Drejtoria për Arsim, Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe kompensime dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-46/2021	Data: Datum: 12.02.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa të datës 12.02.2021, për caktimin e Zyrtarit Alternativ për të nënshkruar në emer të Zyrtarit Kryesor Financiar(ZKF), nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesën e datës 12.02.2021 e parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për caktimin e Zyrtarit Alternativ për të nënshkruar në emer të Osman Sadikaj, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)i cili ka rezultuar pozitiv me Covid19 dhe caktohet **Genc Ademaj**, Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Projekteve për partneritet publiko-privat.
2. **Genc Ademaj**, Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Projekteve për partneritet publiko-privat obligohet si zyrtar alternativ ti kryej punët e ZKF-së deri sa ai të shërohet e të kthehet në punë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëhere pas nënshkrimit të tij dhe fillon të zbatohet nga **Genc Ademaj**, Zyrtari Alternativ.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Genc Ademaj**, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINË MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-47/021	Data: Datum: 12.02.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 58 pika h). të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), dhe nenin 10. paragrafi 5 i Rregullores Komunale për punën e Kuvendit të Komunës së Istogut Nr.2/2013, shqyrtoj kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim për Formimin e Komisionit për Plotësim ndryshimin e Rregullores për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01 Numër: 48/2015 të datës:29.05.2015, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për Plotësim ndryshimin e Rregullores për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01 Numër: 48/2015 të datës:29.05.2015 dhe në këtë komision caktohen:

- 1.1. **Enver Rugova**, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, anëtar;
- 1.3. **Zekije Sutaj**, Udhëheqëse e Sektorit Ligjor, anëtare;
- 1.4. **Vjosa Hysenaj**, Zyrtare e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunes, anëtare;
- 1.5. **Muhamet Gusturanaj**, Udhëheqës i Sektorit për Integritet Evropian, anëtar;
- 1.6. **Blerim Bujupaj**, Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar dhe
- 1.7. **Flora Bujupaj**, Asistente Administrative e Kryesuesit të Kuvendit, anëtare.

2. Komisioni do të bëjë Plotësim ndryshimin e Rregullores për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01 Numër:48/2015 të datës:29.05.2015; do të njoftojë rregullisht Kryetarin me ecurinë e punës për plotësim ndryshimin e Projekt-Rregullores të cekur me lartë dhe pas përfundimit një kopje të Projekt-Rregullores do t'ia dorëzojë Kryetarit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe përgjegjësit tjera që janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

4. Komisioni obligohet të filloj me punë menjëherë, të gjitha punët juridike-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryej: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Komisioni, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ





Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-48/021	Data: Datum: 12.02.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 58 pika h). të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), dhe nenin 10. paragrafi 5 i Rregullores Komunale për Punën e Kuvendit të Komunës së Istogut Nr.2/2013, shqyrtoj kërkesën e Drejtorisë për Administratë Komunale për Formimin e Komisionit për hartimin e Projekt- Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për hartimin e Projekt- Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, dhe në këtë komision caktohen:

- 1.1. Edona Bujupi-Loxha,** Drejtoresh e Drejtorisë për Administratë Komunale, Kryesuese e Komisionit;
- 1.2. Hajrush Shoshi,** Drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar;
- 1.3. Zekije Sutaj,** Udhëheqëse e Sektorit Ligjor, anëtare;
- 1.4. Muhamet Gusturanaj,** Udhëheqës i Sektorit për Integritet Evropian, anëtar;
- 1.6. Arlinda Kurtaj,** Udhëheqëse e Sektorit Administrativ dhe anëtare;
- 1.7. Vjosa Hysenaj,** Zyrtare e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunes, anëtare.

2. Komisioni do të bëjë hartimin e Projekt- Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e fëmijëve; do të njoftojë rregullisht Kryetarin me ecurinë e punës për hartimin e Projekt- Rregullores të cekur me lartë dhe pas përfundimit një kopje të Projekt- Rregullores do t'ia dorëzojë Kryetarit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe përgjegjësit tjera që janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Drejtoria për Administratë Komunale.

4. Komisioni obligohet të filloj me punë menjëherë, të gjitha punët juridike-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryej: Drejtoria për Administratë Komunale.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Komisioni, Drejtoria për Administratë Komunale dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-49/2021	Data: Datum: 16.02.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Vlerësimi strategjik mjedisor" me numër të jashtëm prokurimi 633-21-249-2-3-6 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-001-236, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Vlerësimi strategjik mjedisor" me numër të jashtëm prokurimi 633-21-249-2-3-6 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-001-236, dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Dukagjin Hoxhaj**, Inxh. i komunikacionit, Zyrtar për Regjistrim të Adresave, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Rrustem Gashi**, Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim, anëtar dhe
- 1.3. **Shefqet Imeraj**, Zyrtar i Prokurimit 2, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: "Vlerësimi strategjik mjedisor" si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartëcekur e merr Komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Prokurimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedisë dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-50/2021	Data: Datum: 18.02.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), më qëllim të formimit të Grupit Punues për plotësimin e formularit të Vetëvlerësimit për Menaxhimin e Financave dhe Kontrollit për vitin 2021, nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet grupi punues për plotësimin e Formularit të Vetëvlerësimit për Menaxhimin e Financave dhe Kontrollit për vitin 2021 dhe në grupin punues caktohen:

- 1) Haki Rugova, Kryetar i Komunës, Kryesues i grupit,
- 2) Agim Ademaj, Nënkryetar i Komunës, anëtar,
- 3) Edona Bujupi-Loxha, Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratës Komunale, anëtare,
- 4) Demë Çeta, Drejtor i Drejtorisë për Inspektion, anëtar,
- 5) Hysni Maxharraj, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet e Financa, anëtar;
- 6) Enver Rugova, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar,
- 7) Lulzim Shoshi, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, anëtar,
- 8) Lulzim Blakaj, Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe zhvillim,
- 9) Hazbi Bajraj, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar,
- 10) Jashar Blakaj, Drejtor i Drejtorisë për planifikim Urbanë dhe Mjedis, anëtar,
- 11) Mujë Osmanaj, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, anëtar,
- 12) Drin Sadikaj, Drejtor i Drejtorit për Kulturë Rini dhe Sport, anëtar,
- 13) Hajrush Shoshi, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar;
- 14) Osman Sadikaj, Zyrtar kryesor Financiar, anëtar,
- 15) Fatmir Bytyqi, Udhëheqës i Personelit, anëtar;
- 16) Rasim Mahmutovic, Shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtar,
- 17) Riza Alihajdaraj, Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, anëtar,
- 18) Zize Bujupi, Menaxhere e Prokurimit, anëtare,
- 19) Genc Ademaj, Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Projekteve për partneritet publiko-privat, anëtar.

2. Grupi punues i lartcekur ka për obligim që të kontribuoj në plotësimin e Formularit për Vetëvlerësim për Menaxhimin e Financave dhe Kontrollit për vitin 2021.

3. Me kopje të këtij vendimi njoftohen: Kryesuesi i grupit punues dhe anëtarët tjerë, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-54/021	Data: Datum: 23.02.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 52 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 paragrafi 2 nenparagrafi 2.1 dhe paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2019), shqyrtojë kërkesën 02 Nr.03/021 të datës 22.02.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Administratë Komunale, për transferimin e përkohëshme të Sami Shatrit me titull të vendit të punës Zyrtar për Gjendje Civile 4. në vendin e punës Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile dhe nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** kërkesa 02 Nr.03/021 të datës 22.02.2021 e parashtruar nga Drejtoria për Administratë Komunale për transferimin e përkohëshme të Sami Shatrit me titull të vendit të punës Zyrtar për Gjendje Civile 4. në vendin e punës Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile në kuader të Drejtorisë për Administratë Komunale.
- I lartëpërmenduri nga data 26.02.2021 mund të ushtroj përkohësisht detyren e Udhëheqësit të Sektorit për Gjendje Civile për periudhën kohore siq e parasheh Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik.
- Pas përfundimit të ushtrimit të përkohëshëm të detyrës si Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile, Sami Shatri mund të kthehet përsëri në vendin e punës si Zyrtar për Gjendje Civile 4.
- Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të percjellë Vendimin tek Divizioni i Pagesave në Ministrinë e Financave për Sami Shatrin të cilit i garantohet vendi i punës sipas pikës 3 të këtij Vendimi.
- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Administratë Komunale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Personelit.
- Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Sami Shatri, Drejtoria për Administratë Komunale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Menaxheri i Personelit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Blaki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.55/021	Data: 25.02.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 22 paragrafi 2 nenparagrafi 2.2. të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) dhe nenit 19 të Rregullore Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj lajmërimin 02 Nr.06/021 të datës 25.02.2021 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për pagesën e një page mujore me përfundimin e shërbimit-pensionimin e Selman Blakaj, nëpunës civil me titull të vendit të punës: Udhëheqes i Sektorit për Gjendje Civile, nxjerr:

V E N D I M

1. **KOMPENZOHE**: Selman Blakaj, nëpunës civil me titull të vendit të punës: Udhëheqes i Sektorit për Gjendje Civile, në lartësi prej një page mujore të cilën e ka realizuar, për shkak të pensionimit.
2. Nëpunësit civil të lartpërmendur i përfundon shërbimi me 25.02.2021.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Administratë Komunale.
4. Drejtoria për Buxhet dhe Financa obligohet të bëjë pagesën e një page mujore të realizuar, sipas procedurave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Administratë Komunale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Personelit.
6. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Selman Blakaj, Drejtoria për Administratë Komunale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Menaxheri i Personelit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA

Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.57/021	Data: 26.02.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2019), nenin 10 të Rregullorës Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, shqyrtoi kërkesën me Nr.02-08/2021 të datës 25.02.2021 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit Disiplinor dhe nxjerr:

V E N D I M

- 1. FORMOHET:** Komisioni Disiplinor në Shërbimin Civil Komunal në Istog me mandat tre vjeçar dhe në këtë komision caktohen:

- 1.1. Arlinda Kurtaj,** Udhëheqëse e Sektorit Administrativ, Kryesuese e Komisionit;
- 1.2. Rasim Mahmutoviq,** Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, anëtar dhe,
- 1.3. Fatmir Bytyqi,** Menaxher i Personelit, anëtar.

- Komisioni ka kompetencë të bëjë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura si dhe ka kompetencë të përcakton dhe shqipëton masën disiplinore, duke u bazuar në Rregullorën me Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.
- Komisioni disiplinor i formuar sipas pikës 1 të këtij Vendimi ka mandat 3 (tre) vjeçar.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Menaxheri i Personelit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

Haki RUGOVA